



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 14432 Prot

Vlorë, më 18 of 09 2024

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

RAJONI 3

Datë 11.09.2024 ora 10:00

Tema: Konsultimi i Programit të Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2025 për Bashkinë Vlorë

**Baza Ligjore:** Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nen 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 nen 5, pika 1,2,3,4 nen 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.13107 datë 21.08.2024.

**Marrin pjesë:**

Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha, Kryetari i Rajonit 3- Manuela Prifti, Drejtori i DFKB-Kozma Mali, anëtar të këshillit bashkiak, drejtore të administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, media dhe OJF lokale.

(Në takim morrën pjesë më shumë se 60 persona, listeprezenza bashkangjitur)

**Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha:** Përvendetje, të gjithëve! Ju falenderoj për pjsëmarrjen dhe uroj të jeni mirë me shëndet.

Jemi mbledhur për të prezantuar projekt buxhetin afatmesëm të Bashkisë Vlorë 2025-2027. Sezoni ka patur problematika dhe ngarkesë të madhe. Kemi bërë përpjekjet e mundshme për ta

menaxhuar, Kemi qënë gjithmonë në terren për t'ju shërbyer qytetarëve tanë dhe për ata që zgjodhën Vlorën si destinacion për pushimet.

Kemi hasur në problematikën e zjarrvénies te mbetjet ashtu si dhe në vitet e mëparshme. Ky është shqetësim i madh për mua. Bashkia ka vazhduar procedurën për Sherishtën dhe pastaj të vazhdojmë me kapsulimin e zonës sa më shpejt, që të mos kemi probleme.

Kolegët e bashkisë kanë bërë prezantim për investimet e buxhetit 2024. Disa nga projektet janë realizuar së bashku me FSHZH.

Një nga investimet ishte dhe rruga e Cipajve e cila do ndiqet si model për standartin për asfaltimin, vijëzimin, ndriçimin edhe përrugët e tjera.

Problem është investimi i realizuar nga Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Bankën Gjermane për Zhvillim për infrastrukturën e ujit të pijshëm. Efekt jo i kënaqshëm vizualisht dhe ka krijuar ndotje të ambientit edhe pse i kemi larë vazhdimisht rrugët. Posedojmë vetëm 1 bot dhe kemi marr me qera dhe 3 të tjerë. Kompania që ka fituar projektin ka afat 18 muaj përfundimin. Ky investim shumë i rëndësishëm i shërben furnizimit me ujë të pijshëm por ka këto kosto ambienti në zbatim të procedurave. Kërkoj ndejsë dhe mirëkuptim deri në përfundim të projektit. Deri në fund të vitit segmentet e shtruara do të testohen dhe të filloj asfaltimi i pjesshëm i rrugëve. Përkështetje arsyesh nuk kemi vazhduar me shtrimin e rrugëve në mënyrë që të finalizohet projekt i ujësjellësit.

Për sa i përket investimeve janë:

Rikonstrukioni i shkollës Lef Sallata, edhe pse me vonesë por u mbyll procedura dhe u përzgjodh edhe kompania fituese, do të fillonë punimet e projektit. Parashikohet një shtesë kati në shkollë si dhe palestra e shkollës. Kam studuar në atë shkollë, punimet do i ndjek që cdo gjë të bëhet sipas standartit.

Rikonstrukioni i kopshtit nr.10. Ka përfunduar projekt i dëgjimit i një proces tenderimi. Brenda vitiit do të fillojnë punimet.

Rikonstrukioni i lulishtes dhe murit rrethues te Shkolla Ali Demi. Ka përfunduar projekt i dëgjimit i një proces zbatimi. Do të realizohet ambient sportive dhe ndricimi.

Sistemimi i disa akseve rrugore në Rajonin 3, rruga e Varoshit, rruga te Kisha, segmentet e brendshme, vijëzim duke ndryshuar cilësinë e bojës në mënyrë që të mos fshihen për një muaj. Është punuar me materialet gjendje.

Kemi marr ankesa dhe sygjerime për lëvizshmërinë, s'ka semafor në Vlorë. Nga një studim i mëparshëm i një arkitekti urbanist hollandez, për semaforët në qytet, mendohet se nuk funksionon shumë semafori edhe për shkak të rotondove. Kemi një projekt edhe për rajonin 3 disa segmente kryesore si rr. Cipajve, te Albano dhe Romina, te Rinia, Sheshi i Flamurit të vendosene semafor. Këto janë cfarë duam të bëjmë.

Rruga përballë shkollës Naim Frashëri ka patur ankesa dhe do shikohet.

Rikonstruktion i bllokut të banesave pranë shkollës Lef Sallata.

Sistemim i akseve rrugorë të mbaruara.

Rikonstruksion i Galerisë së Arteve.

Kemi një projekt me FSHZH me financim të BE EcoCity, lëvizja dhe mobiliteti urban, rruga përball me portin për një zonë rekreative.

Probleme ka pafund. Jemi të orientuar edhe me KB, me konsensusin e anëtravë të KB, jo vetëm të maxhorancës, procedura do i japi vrull investimeve.

Tani dua të dëgjoj nga ju. Jemi në kohë për problemet dhe ti zbatojmë në buxhet për 2025-2027.

**Qytetar:** Vlora ka 20 vjet që ka bërë përparime. Por ka dhe gjëra të vogla. Dua të tregoj për një rast me turistët. Ishim para muzeut dhe pyesnin turistët për emrat e busteve. Janë pa emra. U drejtova te drejtoresha dhe me tha s'kemi fond. Duhen vendosur emrat sepse vijnë të huaj dhe kosovarë dhe duan ti njohin. Te kisha katolike ka gropë të mëdha që pengojnë ecjen e njerëzve në trotuare. Nuk i shikon përgjegjësi? Me 2 kova beton ti rregullojnë. Ra shiu para dy ditësh, degët e pemvëe janë thyer dhe në rrugën kryesore të pengojnë kur kalon. Duan përkujdesje. Pallati 1251 te Tregu i Orizit është shumë pis. Ja kam thënë dhe deputetes këtu present. Mbushini gropat. Kryetar kam qënë 27 vjet drejtor shkolle, ka patur njerëz që kur punojnë e zbardhin punën dhe të tjerë që e nxijnë punën. Drejtori që ke vënë të marr përsipër të bëj punën jo me shok e mik sepse ka vajza e djem të mirë që duan të punojnë. Ata që të servilosën janë nga shpirti të këqinj.

**Ermal Dredha:** Po ju bëjmë gjyq publik sabotuesve. Ju falenderoj për të gjitha që folët.

**Qytetar:** Përfitoj se jam banor i lashtë i këtij rajoni edhe pse nuk jam Vlonjat. Të shkolla Ismail Qemali. Parafolsi ka të drejtë për shqetësimet që ngriti. Duam ti zgjidhim në mënyrë civile problemet. Pushtetit lokal i bëj vërrëjtje. Ose është i avashtë ose është neglizhent. Kryetari s'ka faj. Qyteti dhe përgjegjësia filllon nga banorët. Kryetari i rajonit dhe pastaj më lart. Kam vité me një problem. Kam bërë ankesa të shumta. Pallati që është ndërtuar s'ka respaktuar distancën. Kemi dhënë miratimin për shtesë katër, me leje të kryetarit, por jo për prishje të trotuaret. Shikoni procesverbalet e dorëzimit. Në datën 15 gusht kam bërë ankesë me foto në bashki, sepse bllokuan me zinxhirë ambientin e përbashkët. Një kopje të procesverbalit e mbajti kryetarja e rajonit.

Kam bërë nakesë për një vendsterhim të shkolla Lef Sallata, është pisllék i madh, nuk kalon dot. Rregullat dhe ligji nuk janë personale.

**Ermal Dredha:** Dua të bëj disa sqarime të vogla. Duam të korigojmë cfarë është mbartur. Grabitja e hapësirave publike. Kemi vepruar me Policinë Bashkiake dhe kemi liruar disa por janë uzurpuar prape. Kam nxjerr urdhër për ti konstatuar nëpër lagje dhe ti prishin kur nuk janë të

legalizuara. Të lirojmë hapsirat publike të përbashkëta dhe të shohim mundësinë për të bërë parqe. Shumë shqetësime që vijnë kanë të bëjnë me administrimin e pronave, 2 kompani që janë në administrim për tarifat e pallateve dhe rrëth pallateve. Duhet një bashkëpunim me administratorit për të mirën e komunitetit. Kanë përgjegjësi për territorin përreth. Bashkia nuk e bën dot e vetme që të ketë duk puna. Kemi 26 mjete teknologjike të reja. Vështirësohen puna në sezon por do kujdes të vecantë nga banorët. Mobiljet dhe inertet hidhen ku të munden nëpër kosha dhe pastaj e ka fajin bashkia. Po kaloja te rruga e plazhit të vjetër dhe 2 persona me divan në krahë dhe placka po i depozitonin para koshit të plerave. Ju thash: merrni makinën e e bashkisë dhe hidhini aty ku duhet. E futën divanin brenda në kazan. Dëmin e bëjnë vetë, cfarë na takon ta bëjmë sic duhet edhe ju edhe ne. I bëjmë dëgjesat të marrim nga ju shqetësimet tuaja.

**Qytetar:** Jam me origjinë nga Vlora por jetoj në Tiranë. Kemi probleme me pallatin dhe administratorët. Në fillim legalizimi pastaj administratorët. Jetoj te Aleksandria. Nuk ka ashensor dhe s'kemi patur ujë. Banorët e pallatit nuk pranonin të bënin pagesat. Duhet administrator. Pallati është pa leje. Ashensori është problem kryesor, ngjitim bidonat 10litra deri në katin e 7..2 herë kemi marr zjarrfiksen. Bëni standarte për ashensorët. Në Tiranë paguajmë, kudo paguajmë vetëm në Vlorë jo. Problem janë dhe plerat pas Aleksandrisë. Cdo mëngjes nxjerrin mbetjet nga koshi që të mbledhin kanacët dhe bidonat. Makina e pastrimit mbledh vetëm kazanët dhe ato mbetje që janë sheshit nuk i pastron. Problem edhe pensionet, pensioni minimal 100 mijë dhe 30 mijë asistencë është turp.

**Ermal Dredha:** Bashkia nuk bën politika shtetërore për pensionet. Qeveria po. Është proces i gjatë.

**Qytetar:** Jam banor i lagjes Lef Sallata. Pallati që ka bërë ushtria nuk është i drejtë, për 10m rrugë hidhen plerat sheshit. Të sistemohet përpara me gjelbërim. Pastrimi gjatë sezonit nuk ishte i mirë.

**Qytetar:** Problemet janë të shumta. Infrastruktura e para. Mungesa e gjelbërimit, betoni me shumicë. Sipas standardeve të BE, parametrat e gjelbërimit maten me m<sup>2</sup>/banorë. Investimet që bëni, të jenë të sakta. Rruga një vit e asfaltuar kanë filluar gropat. Duhen bërë sipas parametrave të duhura pastaj të firmoset dhe merret në dorëzim. Në vendet që ishin makinat e parkuara, asfalti nuk u bë. Ne që vendosëm të jetojmë këtu, duam të dimë cdo bëhet nga bashkia për facilitetet që të përmirësojmë jetën. Problem tjetër, OSHEE, shtroi kabllin 15kw, u vendosen 2 bokse dhe na thanë janë investim privat, paguajnë banorët lekë nga xhepi, s'kanë ca bëjnë do i paguajnë. Të vendoset edhe një boks te ne që të mbledhi kabllot.

**Ermal Dredha:** Para 2 ditësh kam bërë mbledhje me drejtorët e bashkisë. Do ju japim afat kompanive kabllore të sistemojnë telat në qytet brenda afateve, që ti rregullojnë vet duke qënë se kanë investuar, në të kundërt do ndërhyj bashkia ti sitemoj. Edhe për pucetat që janë pa kapak. Ata kanë detyrimin që kur kalojnë fijet ti shtrojnë dhe ti mirëmbajnë kur thyhen ose do t'ju ndërpritet kontrata. Sepse është problem.

**Qytetar:** Përshëndetje, jam dakort me diSkutimin. Keni detyrë të vështirë, por kemi zgjedhur Vlorën dhe kemi investuar këtu. Duke i thënë shqetësimet shpresoj të na dëgjoni. Administratorët po i ndëjtën punës në kokë, bëhet. Ta ndihmojmë komunitetin, personalisht e kam bërë vullnetarisht. Pallati i Cobos ka hile. 10 vjet që banoj aty. Ndërtuesit kanë gjynahë me popullin. Na morën milionat për 2 ashensorë. Njëri u vendos jashtë standartit. Ka ardhur 2 herë zjarrfiksja. Po e ndjekim me avokat, po duam ndihmën tuaj, që mos të vritet njëri. Të vendosin në dispozicion të pallatit, ashensorin që përdorin personalisht. Plerat në Skelë, te Cobo, ka shumë biznese vetëm me 3 kazanë. Duhet të ndërgjegjësohem. Himara ka vendosur kazanë hekuri për plastikën, bashkëpunoni me të tjerë dhe vendosni dhe ju kazanët e plastikës. Problem tjetër qetësia te pallatet e Breshanit dhe Hanxharit. Pamja shumë e mirë por administrimi i keq. Në Skelë u sulmuam 2 turistë nga qentë e rrugës. Është shumë shqetësuese. U ankuam te policia e shtetit, policia bashkiake, në bashki te dr. e Mjedisit Aulona, dhe na tha do e përcillte shqetësimin te ju. Ka shoqata, ka buxhet të dedikuar për qentë e rrugës? Na duket vetja sikur jetojmë në fshat.

**Ermal Dredha.** Duhet të vendoset mardhënie dakortësie midis banorëve të pallatit dhe administratorëve të licencuar. Administratorët të janë Brenda pallatit që ti kërkosh llogari. Qentë e rrugëve, kemi bërë ndërhyrje sepse kanë qenë 300 qenë të pastrehë para pak kohësh.

**Qytetar:** Jam aktivist i shoqërisë civile. Kryetari ka 1 vit e ca që i shërbën Vlorës dhe ka një komunikim absolut. Ka probleme Vlora, plot. Erdhi dhe deputetja, Prnavera Veizi. KM tha që Vlora s'ka as sy as veshë. Kryetarja e rajonit është shumë e mirë. Këruam 200m<sup>2</sup> beton për pucetat dhe pallatet. Policia bashkiake janë uniforma që rrojnë me lekët e bashkisë. Biznesi është agresiv në Transballkanike, njësoj si në Lungomare. Janë shtuar mbi trotuar. Turizmi katastrofë me transportin publik si për zonat rurale dhe urbane. Është problem i mbartur, janë në punë por me mjete që ndotin, oraret e papërshtatshme, pa terminale. Të merret shembull Korça. Bashkia ka bashkëpunim me institucionet e tjera? Bizneset janë bujare, të bashkpunojnë për gjelbërimin e qytetit. Transballkanikja me parcela të reja. Të vendosen edhe stola. Ecomuzeumi. Faleminderit

**Ermal Dredha;** Gjelbërimi do përmirësohet. S'jemi të kënaqur sidomos në thellësi. Përgjatë Transballkanikes edhe në Lungomare duhen bërë me sistem ujitje sepse jo të gjitha kanë funksional sistemin. Do kontraktojmë një kompani për sistemin e ujitjes, projekt me sistem qëndror. Për shtimin e pemëve ke të drejtë.

**Qytetar:** Kam 2 probleme të rëndëshishme. Trafiku sepse bllokohet nga parkimet vend e pa vend të njerëzve. Të vendosen gjoba që të ndërgjegjësohen. Plerat të menaxhohen sic duhet. Biblioteka e qytetit, salla e studimit nuk është dinjitoze për Vlorën.

**Qytetar:** Jam banor në lagjen Rilindja. Kam 3 probleme.

Jam inxhinier elektrik në profesion, linjat elektrike janë të përziera me linjat kablore. Jam edhe ekspert në gjykatë. Mos të ndodhi si rasti i ish-pronarit të Shpellës së Fikut. Bashkia të ngre komisione dhe të merren masa teknike dhe administrative për situatat.

Te rruga Albano dhe Romina, suvatimet e jashtme të pallateve janë shumë të vjetra, janë ndërtuar para 50 vjetësh.

Problemet me aluizmin dhe legalizimet pse s'po ecin?

**Ermal Dredha:** Nuk jemi për show këtu. Procesi po vazhdon por s'mund të krahasosh qytetet e vogla me Vlorën. Janë ngritur struktura me njerëz që do të punojnë për procesin. Po nënshkruhen programet me Hipotekën, stafi prej 11 personash do të punoj bashkë me ASHK dhe do kordinohet procesi. Vlora ka 4-fishin e Shijakut.

**Qytetar:** Te rruga e Cipajve, në katet e para janë furrat e bukës dhe pasticeritë. Erërat e gatimeve na vijnë në shtëpi, nuk hapi dot dritaret. Jemi ankuar dhe nuk është bërë gjë. Ata të punojnë por dhe ne kemi të drejtë të jetojmë sic duhet.

**Ermal Dredha:** Policia bashkiake është informuar për këtë problem tubot do shikohen të nxjerrin tymrat në nivel mbi pallat.

**Qytetar:** Afërdita Shabani kam punuar 35 vjet në shëndetësi. Vlorën e di mirë. Pallati 1039 kemi një lulishte para. Më para ishte mbjellë. Kërkojmë 2 stola jemi 5 pleq. Kam që në 1974 që jetoj aty. Ka pengesa rruga. Kam bërë ankesë në bashki, më thanë do vi INUK. Te tregu te kthesa, një kioskë, është shndëruar në banjo publike, një bolier ka rënë në shesh. Makinat, tregtarët i shesin në rrugë. Është një barankë. Mbas pallatit s'kalon dot zjarrfiksja. Vajta te nënkyetarja kërkova 2 stola në lulishte.

**Ermal Dredha:** Stolat nuk është kérkesë madhore. Sistemimi i lagjes është problem, ke të drejtë. Do fillojmë të rregullojmë gjérat minimale, Zambak.

**Qytetar:** Jam jabanxhi, jo vlonjat. Aty ku banoj te tregu i orizit është vendi më i pisët. Nuk dizinfektohet. Në pallat duhet të kalojmë me cizme. Plazhet publik i kontrollon bashkia? Nuk na lejojnë të vendosim peshqira ata të plazheve privat. Vini dorë te plerat.

**Ermal Dredha:** Nuk heq asnjë presje nga ato çfarë na takojnë ne si bashki. Biznesi që ushtron aktivitet i lënë kartonat jashtë koshave dhe nëpër rrugë. Bizneset të bëjnë punën e tyre. Do vendosim gjoba.

**Qytetare:** Kam një shqetësim shumë të madh dhe nuk di nëse bëj mirë ta them. Kam qënë dhe në burg 5 orë për shkak të konfliktit të krijuar. Te pallati është një lavazho që parkohen makina e fugona, të cilët na pengojnë. Ndihem e kërcënuar.

**Ermal Dredha:** Do hiqen lavazhot.

**Qytetar:** Parqe për fëmijë dhe të moshuar nuk kemi në lagje. Parkimi i makinave është problem i madh.

**Ermal Dredha:** Kemi bërë procedurën për parkimin e qytetit. Do të caktohet një pagesë për hapsirën përvec rezidentëve. Tarifë minimale vjetore. Me pagesën ka dhe një hapsirë tjetër që do

menaxhohet nga bashkia të vinë të ardhura për bashkinë. Po shikohet edhe për parkimet nëntokësore. Për parqet janë 5 projekte që do ti fillojmë brenda vitit. Ato zona që kanë qënë parqe do rehabilitohen dhe do kthehen sic ishin. Kuptohet aty ku s'ka legalizime, që mos të shkojmë në gjykatë.

**Qytetar:** Kërkoj të rishikohet pagesa e ndihmës ekonomike sepse 40 mijë është shumë pak, si dhe të ndimohem me pakoh ushqimore.

**Qytetar:** Ka probleme të mbartura. Janë 3 shtëpi të braktisura pranë kishës. Kemi bërë shkresë, të vihet dorë sepse janë kthyer në problem për ne që banojme aty. Mbytemi nga shiu dhe kanalizimet, s'na përgjigjen në telefon kur i marrim ata të bashkisë.

**Ermal Dredha:** Jam në dijeni të rastit të shtëpive te kisha. Zyra e urbanistikës do e shikoj të ndryshoj destinacionin.

Ju falenderoj për kohën dhe pjesëmarrjen!

**Koordinatore për njoftimin dhe konsultimin publik**

Albana Naçi

